

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-43730
Më 10.1.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, rreth mbështetjes financiare për organizimin e ceremonisë lidhur me shpalljen e më të dalluarve nga lëmi i sportit, rinisë dhe kulturës për vitin 2013, kryetari i Komunës më 10 janar 2014, miratoi këtë:

V E N D I M PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, rreth mbështetjes financiare për organizimin e ceremonisë lidhur me shpalljen e sportistëve më të mirë dhe shpalljen e më të dalluarve nga lëmi i rinisë dhe kulturës për vitin 2013, kështu që, me qëllim të organizimit të kësaj ceremonie, lejohen mjetet e nevojshme.

Shpenzimet e ceremonisë përkatëse do të mbulohen pas prezantimit të faturave.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicionet e subvencioneve dhe mallrave dhe shërbime.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja